“Udhëzuesi hartohet në mbështetje të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar; ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit; udhëzimin “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen në Arkivin e AIDSSH, mënyrën e përdorimit dhe shfrytëzimit të dokumentacionit arkivor”, miratuar me vendim nr. 201, datë 21.05.2022; rregullore nr. 25, datë 25.05.2017 “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në AIDSSH”; udhëzues mbi rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave nga çdo person”, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 177, datë 04.04.2024, i ndryshuar; udhëzues “Për aksesin dhe përdorimin e arkivit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për institucione të kërkimit shkencor, gazetarë, media dhe studiues”, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 743, datë 19.12.2024; udhëzues “Mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave individuale, për zbardhjen e bashkëpunëtorëve të ish-sigurimit të shtetit”, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 538, datë 07.10.2022, i ndryshuar; udhëzues mbi politikat dhe procedurat për trajtimin e kërkesave të palëve të prekur, të treta, bashkëpunëtorëve dhe të favorizuarve, miratuar me vendim të Autoritetit nr. 408, datë 18.09.2025; urdhrin të Kryetares së Autoritetit nr. 49, datë 24.02.2025 “Për ngritjen e grupit të punës për regjistrimin e praktikave të trajtuara të vitit 2024 në sistemin e arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave”; Planit Strategjik të AIDSSH 2023-2028”.
5. Përditësimin në nenin 3 “baza ligjore” të udhëzuesit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit informatik të arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, versioni fillestar 1.0, për një fazë testimi të sistemit”, miratuar me vendimin nr. 154, datë 12.03.2025 me përmbajtje sipas përcaktimeve në pikën 2, më sipër.
6. Përditësimin e nenit 1 “Objekti” të udhëzuesit “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit informatik të arkivës digjitale dhe menaxhimit të kërkesave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, versioni 1.0, miratuar me vendimin e Autoritetit nr. 154, datë 12.03.2025, me përmbajtje si më tej: “Ky udhëzues ka për objekt organizimin, funksionimin e brendshëm dhe përcaktimin e procedurave për përdorimin e Sistemit të Arkivës Digjitale dhe Menaxhimit të Kërkesave, përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të strukturave përdoruese të sistemit, procedurat e komunikimit ndërmjet tyre, administrimin e praktikave të ardhura në funksion të kërkesave dhe dokumentacionit përkatës.”
7. Përditësimin e manualit teknik i përdorimit të SADMK, sipas aneksit IV të udhëzuesit “Për organizimin dhe funksionimin e Sistemit Informatik të Arkivës Digjitale dhe Menaxhimit të Kërkesave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, versioni fillestar 1.0, për një fazë testimi të sistemit” miratuar me vendimin nr. 154, datë 12. 03. 2025, si më tej: “Shtohet seksioni Statistika, në fq.39-fq. 40 të manualit teknik të përdorimit të SADMK.”
8. Në vendimin të Autoritetit nr. 154, datë 12.03.2025, shtohet pika e re e tij me përmbajtje:

“Të përgatitet dhe miratohet urdhri i Kryetares së Autoritetit “për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e mbarëvajtjes së “Sistemit të Arkivës Digjitale dhe Menaxhimit të Kërkesave” gjatë regjistrimit, trajtimit dhe administrimit të kërkesave për informim të ardhura në AIDSSH përgjatë vitit 2025 e në vijim”.

9.Ngarkohet Sekretariati Teknik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Skënder Vrioni, Gjergj Marku



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

AIDSSH, MARRËVESHJE ME INSTITUTIN ALBANOLOGJIK TË PRISHTINËS

Tiranë, 12 shtator 2025



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit priti përfaqësuesit e Institutit Albanologjik të Prishtinës, të kryesuar nga Prof. Asoc. Dr. Meliza Krasniqi dhe kurorëzuan një marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e projekteve të përbashkëta, shkëmbimit të dokumentacionit dhe forcimit të lidhjeve akademike në fushën e studimeve historike.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, theksoi kompleksitetin e historive të jetëve njerëzore që dokumentohen në Fondin e Kosovës, ku pasqyrohen fatet e qytetarëve që u larguan nga shtypja e të drejtave etnike e kulturore dhe trajtimin e tyre nga ish -Sigurimi. Ky partneritet do të kontribuojë në hulumtimet shkencore historike me një qasje të kujdesshme etike dhe ligjore.

Përfaqësuesja e Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prof. Asoc. Dr. Meliza Krasniqi vlerësoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi në fushën e kërkimeve shkencore dhe në ndriçimin e historisë sonë të përbashkët.

Anëtarë i Autoritetit, z. Altin Hoxha, prezantoi “Fondin Kosova”, ndërsa z. Selami Zalli, drejtor i Drejtorisë së Informacionit, solli në vëmendje punën e bërë deri tani në Autoritet me këtë fokus.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit parashikon realizimin e kërkimeve shkencore, si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta, konferenca dhe simpoziumeve, shkëmbimi i dokumenteve dhe publikimeve, si dhe studimi i figura historike e ngjarje të lidhura me periudhën e diktaturës.

Disa nga format e bashkëpunimit për vitin 2026 priten të jenë: hapja në Prishtinë e ekspozitës së tipologjive të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit; bashkëpunimi i Simpoziumit për Kalimet e Dyanshme në Kufirin Verilindor Shqipëri-Kosovë; organizimi i Dosjeve të Hapura për figurat historike të Albanologjisë; Klube Libri, si dhe botime të përbashkëta me dokumentare me interes publik.

Bashkëpunimi i Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) me Institutin Albanologjik të Prishtinës është i rëndësishëm për shumë arsye: së pari, ky bashkëpunim lejon shkëmbimin e njohurive dhe burimeve arkivore për të dokumentuar dhe analizuar periudhën 1944-1991 në të dyja territoret, duke ofruar një perspektivë më të plotë të përndjekjeve dhe politikave represive të ushtruara nga Sigurimi i Shtetit dhe organet jugosllave.

Së dyti, ai forcon drejtësinë tranzicionale përmes studimit të përbashkët të dosjeve, duke ndihmuar viktimat dhe historianët të gjejnë të vërtetën për ngjarje si demonstratat e vitit 1981 apo spastrimet etnike në Kosovë.

Së treti, ky partneritet kontribuon në ndërtimin e një narrative të përbashkët historike mes Shqipërisë dhe Kosovës, duke promovuar unitetin dhe edukimin qytetar. Në mbyllje, bashkëpunimi mbështet integrimin evropian duke ndjekur modele të ngjashme, si p.sh. ai gjerman për menaxhimin e arkivave të regjimeve totalitare, duke e bërë këtë proces një urë për pajtim dhe transparencë.

Më tej grupi i studiuesve u njoh me fondet arkivore si dhe me produktet audiovizuale të Autoritetit, dokumentarët “3 ditët e lirisë” dhe “Ana tjetër e Valiasit”.

Kjo vizitë e përfaqësuesve të Institutit Albanologjik të Prishtinës në Tiranë pason takimin e mëparshëm të zhvilluar në Prishtinë mes përfaqësuesve të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe studiuesve kosovarë.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME INSTITUTIN “ALI HADRI” PËR TË SHKUARËN E PËRBASHKËT

Tiranë 15 shtator 2025



Historia dhe fatet e shqiptarëve në të dy anët e kufirit, në periudha kur Shqipëria jetonte nën regjimin diktatorial dhe Kosova ishte pjesë e Federatës Jugosllave, marrin sot frymë të re përmes një plani të përbashkët studimesh akademike mes Autoritetit të Dosjeve dhe Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë. Mirëprritëm Drejtoreshën e Institutit, Prof. Dr. Teuta Shala, sekretarin shkencor Prof. Ass. Dr. Arbër Hadri dhe ekspertin z. Festim Krasniqi, dhe nënshkruam një marrëveshje e rëndësishme për dokumentimin dhe kuptimin e së kaluarës së përbashkët përmes dokumenteve arkivore dhe botimeve shkencore.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, theksoi rolin vendimtar të këtij bashkëpunimi dhe nevojën për qasje të përgjegjshme ndaj historisë: “Nuk do të lejojmë më që Sigurimi i Shtetit të vendosë për ne. Në rastin e shqiptarëve të Kosovës, janë krijuar dokumente stigmatizuese; ndërsa në rastin e shqiptarëve të Shqipërisë, janë varur njerëz dhe janë persekutuar familje të tëra. Ndaj jemi në kërkim të studiuesve dhe akademikëve të përgjegjshëm që t’i përcjellin këto ngjarje me reflektimin e duhur. Sigurisht që do të deklasifikojmë me kujdes, por duam që dokumentet tona të shërbejnë si dëshmi historike, ashtu si edhe ato të Kosovës, duke u vendosur në duar të përgjegjshme për studim, e jo të vazhdojë përbaltja e nisur nga Sigurimi i Shtetit përmes copëzimit të dokumenteve dhe rihapjes së damkosjes së familjeve.”



Prof. Dr. Teuta Shala dhe Prof. Ass. Dr. Arbër Hadri e konsideruan marrëveshjen një mundësi të re për shkëmbimin e buri-meve arkivore për periudhën 1944–1991, duke ofruar një panoramë më të plotë mbi përndjekjet dhe politikat represive të ushtruara si nga Sigurimi i Shtetit në Shqipëri, ashtu edhe nga organet jugosllave në Kosovë.

Anëtar i Autoritetit, z. Altin Hoxha, vlerësoi punën që do të nisë me përpunimin e fondit arkivor “Kosova”, i cili do të lehtësojë qasjen e studiuesve në burime me rëndësi historike. Anëtar i z. Albert Nikolla nënvizoi rolin e figurave historike e kulturës me kontribute të njohura në dy anët e kufirit, ndërsa anëtar i z. Gjergj Marku theksoi nevojën për të hulumtuar fatet e shqiptarëve të Kosovës që gjetën strehë në Shqipëri, tëurvejuar nga strukturat e ish-Sigurimit.

Z. Skënder Vrioni, anëtar, vlerësoi ngritjen e një grupi të përbashkët teknik për finalizimin e projekteve akademike të përbashkëta.

Marrëveshja parashikon:

- shkëmbimin e planeve vjetore, projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta në fillim të çdo viti kalendarik;
- organizimin e konferencave dhe simpoziumeve mbi diktaturën komuniste, ish-Sigurimin e Shtetit dhe represionin politik ndaj shqiptarëve;
- pjesëmarrjen reciproke të punonjësve në ligjërata dhe kumtesa;

- publikimin e studimeve të përbashkëta në revista shkencore dhe botime tematike;
- informimin e ndërsjellë mbi çështje e dokumente me interes kombëtar;
- ngritjen e grupeve të përbashkëta për studimin e figurave historike dhe personaliteteve të albanologjisë;
- mbledhjen dhe publikimin e materialeve arkivore sipas legjislacionit në fuqi.

Kjo marrëveshje ka një rëndësi që tejkalon fushën akademike: ajo është një akt afrimi dhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Kosovës, në funksion të rishqyrtimit të së shkuarës dhe të ndërtimit të një perspektivë që parandalon përsëritjen e plagëve të së shkuarës.

AIDSSH MIRËPRET FESTIVALIN E FILMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Tiranë, 16 shtator 2025



Biblioteka e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në bashkëpunim me Akademikën “Marubi”, u bë skenë e një aktiviteti unik në kuadër të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut.

Aktiviteti përcolli mesazhe nga tema aktuale dhe sfiduese “Të drejtat e njeriut në epokën digjitale”, duke sjellë në vëmendje lidhjen mes kujtesës historike dhe angazhimit për të mos lejuar përsëritjen e shkeljeve të rënda të së kaluarës.

Të pranishmit ndoqën shfaqjen e dy filmave dokumentarë me metrazh të shkurtër, që e trajtojnë humbjen e identitetit dhe traumën njerëzore gjatë diktaturave në vende të ndryshme:

“*Stolen Identity*”, që rrëfen historinë e Daniel Santucho Navajas në Argjentinë, i cili në moshën 46-vjeçare zbulon identitetin e tij të vërtetë përmes databazës së ADN-së. Filmi prek plagën e 133 fëmijëve të lindur gjatë diktaturës ushtarake, duke sjellë pyetje mbi identitetin dhe drejtësinë.



“303” – Burgu i Spaçit, një dokumentar eksperimental mbi jetën e të burgosurve politikë në Spaç, ku përmes tingujve dhe gjuhës së trupit pasqyrohen dhimbja, heshtja dhe qëndresa e të dënuarve dhe familjeve të tyre.

Anëtari i Autoritetit z. Skënder Vrioni tha se: “Ky aktivitet tregon përkushtimin e AIDSSH-së për të përdorur artin dhe edukimin si ura reflektimi mbi të kaluarën, duke afirmuar kujtesën dhe duke forcuar kulturën e të drejtave të njeriut në Shqipëri”.

Regjisori Kujtim Çashku vlerësoi bashkëpunimin me AIDSSH-në dhe rolin e të rinjve në ruajtjen e kujtesës, duke përmendur projektin e studentëve të Akademisë Marubi mbi Burgun e Spaçit.

Sipas tij zgjedhja e dy filmave nuk ishte rastësore: të dy rrëfejnë, secili në mënyrën e vet, humbjen e identitetit dhe nevojën për ruajtjen e mendimit kritik edhe në shoqërinë e sotme.

Znj. Brunilda Çërraga, përgjegjëse e sektorit për Edukimin Qytetar solli në vëmendje se qasja e re e filmit mbi Spaçin vendos në qendër edhe gratë – nënat, motrat dhe bashkëshortet që përjetuan mungesën dhe vuajtjet, por ruajtën dinjitetin dhe elegancën.



Znj. Roven Rrozhani, shkrimtare, tërhoqi vëmendjen e artistëve pjesëmarrës të filmit “303” tek ekspozita e siluetave të Spaçit, të krijuar nga AIDSSH duke u ndalur te figura e grave që përshkonin rrugën e mundimshme drejt takimeve me familjarët në Spaç, si një burim për të nxitur një performancë artistike më gjithëpërfshirëse. Ajo gjithashtu theksoi punën e Autoritetit në edukimin e brezave të rinj përmes botimeve, albumeve, librave për fëmijë dhe platformës spac.al, duke ofruar mjete konkrete për të kuptuar historinë.

Një nga të mbijetuarit e përndjekjes nënvizoi se transmetimi i filmave të tillë është mënyra më e drejtpërdrejtë për të ndriçuar rininë mbi krimet e diktaturës. Përfaqësuesit ndërkombëtarë theksuan rëndësinë e vendosjes së filmave në një kontekst historik që i jep kuptim të plotë mesazhit.

Diskutimet u pasuruan nga Prof. Theodore Orlin, presidenti i Festivalit, Znj. Erida Skendaj, drejtuese e Komitetit Shqiptar i Helsinkit, përfaqësues të Delegacionit Evropian, si dhe autorë e aktorë të filmave.

ICMP MBYLL SONDAZHET NË 6 VENDVARRIME TË DYSHUARA TË TË ZHDUKURVE

Tiranë, 24 shtator 2025

Në kuadër të projektit “Mbështetja e drejtësisë tranzitore dhe përballja me të shkuarën në Shqipëri”, më datë 24 shtator 2024, në mjediset e Hotel Mondial në Tiranë u zhvillua takimi prezantues i gjetjeve të ekspeditave të para të kryera nga ICMP (Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur) dhe Autoriteti i Dosjeve, në 6 vendndodhje të dyshuara, pjesë e listës prej rreth 120 vendvarrimeve të identifikuara.

Takimi u përshëndet nga Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e cila falënderoi ICMP-në dhe Bashkimin Evropian për mbështetjen logjistike e financiare në procesin e identifikimit dheurvejimit me metoda bashkëkohore shkencore të vendvarrimeve të dyshuara.





Ajo theksoi se ky është një hap i rëndësishëm në përpjekjet për gjetjen e eshtrave të të zhdukurve dhe të varrëve gjatë periudhës së komunizmit, duke vënë në dukje se deri më tani janë regjistruar rreth 400 aplikime nga familjarët e viktimave.

Në fjalën e tij, z. Luigj Ndou, përfaqësues i ICMP-së, prezantoi punën e ekipit të arkeologëve dhe antropologëve, të cilët kryen sondazhe në 6 vendvarrime të dyshuara në Shkodër, Mirditë, Vlorë, Himarë dhe Kolonjë, ndërsa raportet përfundimtare do t'u paraqiten autoriteteve përkatëse në dhjetor të vitit 2025.

Anëtarët e Autoritetit, z. Altin Hoxha dhe z. Gjergj Marku, nënvizuan rëndësinë e bashkëveprim-it institucional mes Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe pushtetit vendor, si një detyrim ligjor dhe moral përballë familjarëve që kanë pësuar humbjet.

Z. Luan Ismaili koordinator/specialist i projektit AIDSSH_ICMP dhe bazës së të dhënave, bëri një prezantim të detajuar të hapave konkretë të ndërmarrë për përzgjedhjen e 6 vendvarrimeve : atë të Varrezave të Rrmajit në Shkodër, 2 vendvarrimeve në fshatin Shpal në Mirditë, një vendvarrim në Selenicë të Vlorës, një në Shën Vasil në Himarë dhe një në Shelegur, në qarkun e Kolonjës. Ai përshkroi veprimet administrative të ndërmarra në drejtim të mbledhjes së dëshmive nga



familjarë apo njerëz që kanë dijeni, studimi dokumenteve të ish Sigurimit dhe kryqëzimi i të dhënave, kryerjen e takimeve përfaqësues të bashkive dhe komunave përkatëse, kompleksitetin e dhe vështirësitë e procesit etj.

Më pas Znj. Sandra Sostaric, koordinatore, përfaqësuese nga ICMP, prezantoi nga afër gjetjet e ekspeditës e cila u bazua në kontaktet me përfaqësues të komuniteteve, dhe u bazua në rilevimet dhe fotografimeve nga afër të terrenit i cili në disa raste ishte i thyer dhe i vështirë për t'u arritur. Ajo analizoi një nga një vendvarrimet e dyshuara duke dhënë rekomandime të personalizuar për secilin bazuar specifikave dhe vështirësive që paraqet secili rast.

Disa nga çështjet që duhen mbajtur parasysh në ndërhyrje është kompleksiteti i terrenit, urgjenca e ndërhyrjes për shkak të rrjedhjeve të ujit apo disa rrjedhave të cilat shkaktonin rrëshqitje të terrenit, zhvendosja e ndonjë strukture që është ndërtuar në afërsi të tyre që e bën të pamundur gjurmimin, problematikat e pronësisë së tokës, gjurmimi në një kuotë të cekët me makineri gjurmuese të vogla, administrimi i gjetjeve gjatë kohës që do të ndërmerren analizat e AND-së për identifikimin e personave bazuar bazës së të dhënave etj.

Në takim morën pjesë përfaqësues të Policisë së Shtetit, pushtetit vendor, organizatave të të përndjekurve dhe të tjerë aktorë institucionalë, të cilët vlerësuan iniciativën dhe theksuan nevojën për zgjerimin e këtyre metodave edhe në vendvarrime të tjera të dyshuara.

Kryetarja e Autoritetit, siguroi të pranishmit mbi angazhimin maksimal të AIDSSH-së për të prezantuar dhe përcjellë punën e bërë tek strukturat kompetente me qëllim çuarjen përpara të këtij procesi sa delikat aq dhe me ndjeshmëri i cili lidhet ngushtë me kujtesën kolektive dhe me drejtësinë tranzicionale. Ajo theksoi edhe një herë se "procesi i kërkimit të eshtrave të të zhdukurve është një rrugëtim i gjatë dhe i ndjeshëm që ka filluar me sondazhet në terren në 6 vendvarrime të dyshuara, për të përcaktuar kushtet, sfidat dhe hapat e mëtejshëm të nevojshëm, por që do të vazhdojë me shtrirjen e kërkimeve edhe në vendndodhje të tjera. Identifikimi i eshtrave kërkon një proces të mëtejshëm shkencor, që përfshin gjurmime të specializuara, analizë ADN-je dhe verifikim dokumentar, i cili do të zhvillohet në vijimësi. Ky është vetëm fillimi i një pune afatgjatë që synon të çojë drejt rezultateve konkrete për familjarët dhe shoqërinë."

TË ZHDUKURIT, ADSSH DHE ICMP, HAPA TË MËTEJSHËM PAS SONDAZHEVE

Tiranë, 30 shtator 2025



Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) zhvilloi një takim pune me znj. Samira Krehic, drejtuese e programit për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), për të përcaktuar hapat e mëtejshëm të bashkëpunimit pas përfundimit të sondazheve në gjashtë vendvarrime të dyshuara në Shqipëri.

Sondazhet, të realizuara nga një grup ekspertësh arkeologë dhe antropologë të udhëhequra nga ekspertë të Autoritetit përgjatë javës së shkuar të shtatorit në: Varrezat e Rrmajit në Shkodër, dy vendvarrimet e dyshuara në Shpal, Mirditë, një në Selenicë, Vlorë, një në Shën Vasil, Himarë, dhe një në Shelegur, Kolonjë, dhanë rezultate optimiste dhe sfiduese. Optimiste përse i përket mundësive të gjetjes së mbetjeve, por njëkohësisht tregojnë për sfida serioze që lidhen me terrene të vështira, zona malore, rrëshqitje të tokës, struktura të mbivendosura, çështje pronësie, si edhe nevojën për administrim të kujdesshëm të gjetjeve dhe analizat e ADN-së.

Kryetarja e Autoritetit, në takim me ICMP-në, vuri në qendër të diskutimit domosdoshmërinë e hapave të prekshëm që e çojnë procesin drejt gërmimeve, duke mbajtur gjallë shpresën e familjarëve për zbardhjen e fatit të të dashurve të tyre.

Këto gjashtë vendvarrime përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të hartës prej rreth 120 vendvarrimesh të dyshuara në gjithë vendin. Procesi është mbështetur logjistikisht nga ICMP dhe Bashkimi Evropian, ndërsa është paraprirë nga hetimet administrative dhe puna arkivore e Autoritetit, i cili gjatë dy viteve të fundit ka siguruar të dhëna dokumentare, dëshmi nga familjarë dhe bashkëpunim me pushtetin vendor për vendosjen e tabelave shënjesuese që mbrojnë këto zona nga tjetërsimi.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit mes Qeverisë së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), si dhe në zbatim të Konventës së OKB-së kundër zhdukjeve me forcë dhe ligjit nr. 45/2015, Autoriteti i Dosjeve, në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së në Tiranë, ka përgatitur edhe një draft-VKM-në që përcakton autoritetet përgjegjëse për gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit (1944-1991), si dhe për mbrojtjen e vendvarrimeve të identifikuara ose të dyshuara. Si ndërmjetës mes familjarëve dhe institucioneve ligj zbatuese, Autoriteti po ndjek hap pas hapi këtë proces të dhimbshëm, por të domosdoshëm për të rikthyer dinjitetin e mohuar të viktimave të komunizmit.

Gjatë periudhës 2017- 2025, administruar rreth 400 kërkesa për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, ndërkohë që numri total i të vrarëve dhe të zhdukurve vlerësohet të jetë rreth 6000 persona. Deri tani AIDSSH ka evidentuar 11 vendvarrime të personave të zhdukur.

RAPORTIMI I RAPORTIT VJETOR TË AIDSSH-SË PËR VITIN 2024

Tiranë, 07 tetor 2025

“Të nderosh Enver Hoxhën do të thotë të mohosh krimet e tij dhe të mos nderosh viktimat”. Kështu deklaroi në seancën dëgjimore për raportimin e veprimtarisë vjetore të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), kryetarja e institucionit, Dr. Gentiana Sula, në përgjigje të shqetësimit të përfaqësuesve të opozitës lidhur me qëndrimin që mbante ndaj futjes së emrit të ish-diktatorit për nderim në një listë figurash historike të lindura në tetor, sipas një e-mail të shpërndarë për deputetët nga sekretaria e Institutit të Studimeve Parlamentare.

Kryetarja shtoi se mund të ketë qenë një lapsus administrativ dhe se AIDSSH-ja është e hapur për të pritur çdo kërkesë nga Kuvendi në raste të ngjashme, kur nevojitet vendimi i Autoritetit.

Në përmbushje të misionit të saj për edukimin qytetar dhe ruajtjen e kujtesës historike, Autoriteti ka avancuar në punën për ndriçimin e së vërtetës mbi periudhën e diktaturës dhe ndarjen e qartë midis viktimave dhe autorëve të krimeve të



saj, shprehur kjo edhe nga kryetarja e AIDSSH-së, Dr. Gentiana Sula, e cila theksoi gjatë raportimit se “nuk mund të ketë asnjë relativizim të krimeve të regjimit dhe asnjë nderim për autorët e tyre. Kujtimi u takon viktimave dhe të mbijetuarve.”

Në raportimin e Raportit Vjetor të AIDSSH-së për vitin 2024, znj. Sula foli për punën e institucionit në shërbim të informimit të qytetarëve, institucioneve, studiuesve dhe medias mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Gjatë vitit 2024, Arkivi dhe procesi i digjitalizimit kanë vijuar me ritme të larta. Janë grumbulluar 3 244 njësi të reja arkivore, që përfshijnë rreth 55 000 fletë dokumente, të ardhura nga institucione të tjera shtetërore. Falë skanimit masiv janë digjitalizuar mbi 3.7 milionë dokumente duke dyfishuar volumin e fondeve arkivore në dy vitet e fundit.

Gjithashtu janë deklasifikuar 17 303 njësi arkivore, që përfshijnë më shumë se 1 milion faqe dokumente, duke rritur ndjeshëm mundësinë e informimit dhe të hulumtimit shkencor.

Në drejtim të së drejtës për informim, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 503 kërkesa të reja, çka përfaqëson një rritje prej 10% krahasuar me vitin e mëparshëm. Në total, janë përpunuar 80 474 faqe dokumentesh, prej të cilave 27 248 faqe janë anonimizuar për mbrojtjen e të dhënave personale. Norma e përmbushjes së kërkesave arriti në 96%, duke reflektuar efikasitetin dhe përkushtimin në ofrimin e shërbimit ndaj publikut.

Procesi i verifikimit të figurave publike ka vijuar gjatë vitit 2024, megjithëse është shoqëruar me disa vështirësi për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga organet e pushtetit vendor, veçanërisht në rastet që lidhen me emërimet në funksione publike, dekorimet dhe dhënien e titujve të nderit. Gjatë periudhës raportuese janë trajtuar 82 kërkesa për verifikim, që përfshijnë 263 kandidatë për funksione publike. Nga këto, 25 individë kanë rezultuar të përfshirë në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me kërkesat e ardhura nga bashkitë dhe institucionet e tjera publike, çka pasqyron rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procesit të verifikimit. Ky proces përbën një hap të rëndësishëm drejt rishikimit të së kaluarës dhe ndriçimit të roleve individuale gjatë periudhës së diktaturës, duke nënvizuar angazhimin e AIDSSH-në për ruajtjen e kujtesës historike, garantimin e transparencës dhe ndërtimin e një kuadri të drejtë për vlerësimin e figurave publike.

Anëtar i Autoritetit, z. Skënder Vroni, theksoi se partitë politike vijnë të mos zbatojnë detyrimet ligjore për transparencën e figurës së kandidatëve në zgjedhje, duke krijuar boshllëqe në zbatimin e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”. Ai i kërkoi Kuvendit të Shqipërisë që të forcojë detyrimet ligjore për bashkëpunim institucional dhe të parashikojë penaltete për moszbatim të ligjit, ose të rishikojë dispozitat ligjore për t’i dhënë Autoritetit kompetenca më të qarta dhe detyruese në këtë drejtim.

Edukimi qytetar është realizuar përmes 6 Klube të Librit “Mësojmë nga e Kaluara” në qytetet Tiranë, Korçë, Lezhë, Kavajë dhe Durrës, me 346 pjesëmarrës, të cilët kanë reflektuar mbi dëshmitë, dokumentet dhe veprat që pasqyrojnë vuajtjet dhe qëndresën njerëzore gjatë diktaturës.

Janë mbajtur dy simpoziume shkencore dhe tre ekspozita arkivore tematike, të cilat kanë synuar të forcojnë kulturën e kujtesës dhe kuptimin e vlerave demokratike tek brezat e rinj. Është lancuar platforma digjitale Spac.al, që i kushtohet kujtesës së burgut politik të Spaçit, ndërsa vijon përgatitja e faqes për Kampin e Tepelenës, një tjetër hapësirë kujtese kushtuar fëmijëve dhe familjeve të internuara.

Në Arkivin Audiovizual të Autoritetit janë mbledhur në total 173 dëshmi, kryesisht nga ish-të burgosur dhe familjarë, që shërbejnë si burim për zbardhjen e historisë së represionit. Për edukimin me të kaluarën për sistemin parauniversitar janë botuar librat “Dielli lind në Spaç” dhe është përgatitur botimi edukativ “Kufij të thyer” me synimin për të sjellë në vëmendje dimensionin njerëzor të së kaluarës përmes edukimit.

Në drejtim të rritjes së cilësisë së studimeve dhe botimeve, anëtar i Autoritetit, z. Albert Nikolla, propozoi ngritjen e një njësie shkencore të specializuar në studimin e dokumenteve arkivore dhe në përgatitjen e botimeve studimore dhe edukative, që do të pasurojnë Platformën Digjitale “Mësojmë nga e Kaluara” dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vetëdije të shëndetshme qytetare për të shkuarën.

Gjatë vitit 2024 janë administruar 59 kërkesa të reja nga familjarët e personave të zhdukur, duke e çuar në 400 numrin total të kërkesave të trajtuara nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Nga 120 vendvarrime të dyshuara të evidentuara deri më tani, 11 janë verifikuar, hetuar dhe shënjuar nga Autoriteti, ndërsa 5 të tjera janë në proces hetimi për vitin 2025.

Në këtë kuadër, është nënshkruar marrëveshja me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) për përdorimin e metodave jo-invasive në kërkimin e vendvarrimeve në Shkodër, Mirditë dhe Himarë. Po ashtu, po zhvillohet trajnimi i stafit të Drejtorisë për përdorimin e platformës ndërkombëtare “Sistemi i Menaxhimit të të Dhënave të Integruara” (IDMS), që do të mundësojë standardizimin dhe digjitalizimin e procesit të kërkimit.

Anëtar i Autoritetit, z. Gjergj Marku, raportoi se, falë bashkëpunimit me OSBE-në, është përgatitur dhe përcjellë projekt-VKM-ja për ngritjen e mekanizmit institucional që do të drejtojë procesin e identifikimit dhe rikuperimit të eshtrave të personave të zhdukur ose të ekzekutuar gjatë periudhës së komunizmit. Aktualisht, projekt-VKM-ja ndodhet për shqyrtim në Ministrinë e Brendshme, dhe pritet miratimi i saj për të mundësuar vijimin e gërmimeve dhe hetimeve. Në vijim të marrëveshjes me ICMP-në, janë realizuar sondazhe në gjashtë vendvarrime, me rezultate optimiste që pritet të konkretizohen.

Për punën e kryer në këtë drejtim, Autoriteti mori vlerësimin dhe mbështetjen e plotë të Kryetarit të Komisionit të Ligjeve, z. Ulsi Manja, i cili garantoj mbështetjen institucionale për miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave për personat e zhdukur, vendim që do të mundësojë zhvillimin e mëtejshëm të gërmimeve dhe hetimeve në terren.

ASNJË PROVË BASHKËPUNIMI NË DOSJEN E MARTIN CAMAJT

Tiranë, 9 tetor 2025



“Gjuha e arratisur ka më shumë jetë se ajo që mbahet rob nën atë flamur”, i shkruan Camaj, Arshi Pipës teksta zezoma e Sigurimit tirrte gracka për të në Tiranën Staliniste. Për të nderuar Martin Camajn, në 100-vjetorin e lindjes së tij, iu bashkuam diskutimit në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit me albanologet Enkeleida Kapia dhe Belfjore Qose, studiuesin Behar Gjoka, shkrimtarin Namik Dokle e të tjerë ku u fol gjatë për cilësitë e tij si albanolog, gjuhëtar, njeri i mendimit dhe i letërsisë shqipe, me një stil të jashtëzakonshëm.

Përmes Altin Hoxhës, anëtar i Autoritetit dhe Selami Zalli, Drejtor i Informacionit në e folëm dhe për fatin e tij si intelektual e qytetar, që u shënjua me vendosjen e regjimit komunist, arratisjen pas presioneve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe shpalljen “armik” për regjimin.

Koha ku ai jetoi dhe krijoi, ashtu siç ishte fati i gjithë intelektualëve shqiptarë të diasporës – të refuzuar, të arratisur për shkak të dhunës nga vendi – shënoi edhe mungesën e tij të gjatë në diskursin shqiptar të komunikimit mbi trashëgiminë e tij”, – tha Alda Bardhyli, Drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.

Enkeleida Kapia, Shefe e Katedrës së Albanologjisë në Institutin e Gjuhësisë, na rrëfeu përmes letërkëmbimit që Camaj kishte me Arshi Pipën, perceptimin e tij mbi Tiranën e asaj kohe, ku nuk mungonte shprehja e dashurisë për atdheun, gjuhën shqipe dhe dhimbja se Tirana ishte kthyer në një laborator të gjuhës së komanduar – një vatër e cenuar nga mungesa e lirisë, me një hapësirë shkencore e kulturore të ndikuar nga politika, që frymëzohej drejtpërdrejt nga Stalini. Por në vlerësimet e Camajt, Eqrem Çabej, ishte i vetmi gjuhëtar që ruante pastërtinë e gjuhës dhe nuk ndikohej nga politika zyrtare.

Hetimi administrativ: Camaj i qëndroi çdo tentative të Sigurimit për manipulim dhe bashkëpunim.

Ndërsa ai krijonte dhe punonte për gjuhën shqipe dhe letërsinë në Itali, Mynih dhe SHBA, në Shqipërinë komuniste Sigurimi i Shtetit e survejonte dhe krijonte dokumente për të – ashtu si për bashkudhëtarët dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë në emigracionin politik, figura të anatemuara nga historiografia komuniste si Ernest Koliqi dhe Arshi Pipa.

Rreth kësaj, anëtar i Autoritetit, Altin Hoxha, foli mbi disa dimensionet e përndjekjes së tij nga Sigurimi i Shtetit, si dhe tentativat për të errësuar figurën e tij përmes kërcënimeve me jetë dhe kombinacioneve të dështuara për ta rekrutuar.

Në përfundim të hetimit administrativ të Autoritetit mbi dosjen e Camajt, Altin Hoxha tha se “Camaj jo vetëm që nuk bashkëpunoi me Sigurimin e Shtetit, por nuk ekziston asnjë dokument raportimi apo version që dëmton figurën e tij. Ai i qëndroi çdo tentative të Sigurimit për manipulim dhe bashkëpunim”.



Po kështu, Selami Zalli, Drejtor i Informacionit në një studim që i bëri dokumenteve arkivore, përmes analizës përcolli tezën se dokumentet që tentojnë të hedhin hije mbi Camajn janë të manipuluar me qëllim zbehjen e ndikimit të tij akademik si albanolog dhe shkrimtar në forumet e larta akademike, jo vetëm në Evropë, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Ndërsa shkrimtari dhe ish-kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Namik Dokle, tha: “E vërteta është e mirë për të gjithë ta dëgjojmë, por kush flet për dosjen Camaj është i neveritshëm. Martin Camaj është shkrimtar, gjuhëtar, patriot. Në mentalitetin e vjetër ai quhet tradhtar, por si shumë të tjerë, ai e ka lënë atdheun me dhimbje, sepse e dinte që po të rrinte, jeta e tij do të rrezikohej, presioni do të shtoej dhe do të humbiste dinjitetin e tij. Kushdo që përpiqet të flasë për dosjen Camaj është i neveritshëm. Ata kanë iluzionin se po të hedhin gurë mbi një pemë, bëhen pemë, por jo – ata mbeten gurë, ndërsa Camaj mbetet një Pemë.”

AIDSSH dhe QKLL vazhdojnë të ndriçojnë rrugën e së vërtetës përmes dokumenteve dhe dëshmive që rikthejnë figurat e mohuara të kulturës shqiptare.

132 - VJETORI I LINDJES SË STANISŁAW ZUBER

Tiranë, 17 tetor 2025



Anëtari i Autoritetit të Dosjeve, z. Albert Nikolla iu bashkua Sh.T. Wojciech Unolt, Ambasador i Polonisë në Shqipëri në nderim të intelektualit të jashtëzakonshëm polak Stanisław Zuber, i cili humbi jetën si pasojë e torturave të Sigurimit të Shtetit.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të 132-vjetorit të lindjes së njërit prej shkencëtarëve më të njohur të Europës së shekullit XX në fushën e kërkimeve në naftë dhe gjeologji, i cili ia kushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij shkencore Shqipërisë.

Figura e inxhinierit Zuber është trajtuar më herët edhe në ekspozitën e dedikuar nga Autoriteti i Dosjeve, ku është nënvizuar kontributin e tij të vyer në zhvillimin e shkencës dhe ekonomisë shqiptare. Përveç ekspozitës dhe aktivitetit institucional, Zuber është nderuar edhe nga bashkitë shqiptare, duke theksuar rolin e tij të veçantë dhe trashëgiminë që la pas.

Stanislav Zuber, inxhinier polak dhe pionier i kërkimit të naftës në Shqipëri, erdhi në vitin 1927 me firmën AGIP dhe zbuloj naftën e Patosit e Kuçovës. Ai hartoi hartën gjeologjike, tektonike dhe minerale të Shqipërisë dhe la një trashëgimi të pasur shkencore me mbi 500 punime dhe skica. Pas Luftës së Dytë Botërore, u thirr si këshilltar pranë Këshillit të Ministrave dhe ministër Nako Spiros, duke kundërshtuar eksportin e rezervave të naftës në Jugosllavi.

Për shkak të njohurive të tij dhe lidhjeve me miqtë shqiptarë dhe të huaj, u përdoq dhe u arrestua më 15 qershor 1947 me akuzën e agjentit dhe sabotatorit të ekonomisë socialiste. Në birucë, ai u torturua, ndërsa dokumentet dhe punimet e tij u sekuestruan.

Fatkeqësisht, Zuber vdiq nën tortura, dhe deri në vitin 1991 askush nuk e dinte se çfarë i kishte ndodhur. Petro Marko, shoku i tij i qelisë, e përshkruan në librin e tij “Retë dhe gurët” si një njeri të goditur, por me energji dhe bindje.

Pas rënies së regjimit, Zuber u nderua me bust në Kuçovë (1991), medaljen “Martir i Demokracisë” (1992) dhe me Urdhrin “Nënë Tereza” (2011).

“MËSOJMË NGA E KALUARA” – KLUBI I LIBRIT NË KONISPOL NDERON HISTORINË E FAMILJES SEJKO

Konispol, 21 tetor 2025

Në kuadër të programit kombëtar të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), në bashkëpunim me Shkollën e Bashkuar “Bido Sejko” dhe në mjediset e Bashkisë Konispol, u zhvillua aktiviteti i radhës i Klubit të Librit “Mësojmë nga e kaluara”, kushtuar librit “Ringjallja e Sejkovëve” të autorit Ylli Polovina – një dëshmi e rrallë mbi historinë tragjike të familjes Sejko, një prej familjeve më të goditura nga regjimi komunist.

Znj. Brunilda Çërraga, përfaqësuese e AIDSSH-së, theksoi se “Klubi i Librit dhe dokumentet përballë historisë na japin mundësinë të mësojmë të vërtetën për familjet që janë ndëshkuar padrejtësisht. Vetëm duke ballafaquar dokumentet me kujtesën mund të kuptojmë dhimbjen që ato familje kanë përjetuar.”

Zv.kryetari i Bashkisë Konispol, z. Julian Lako, falënderoi pjesëmarrësit dhe njoftoi angazhimin e bashkisë për të vënë në dispozicion dy ambiente për krijimin e muzeve kushtuar periudhës së komunizmit në krahinën e Konispolit, si një mënyrë për të mbajtur gjallë kujtesën dhe për edukimin e brezave të rinj.



Anëtari i AIDSSH-së, z. Gjergj Marku, solli në vëmendje historinë e Teme Sejkos, kundëradmiral dhe komandant i Flotës Detare Shqiptare, i cili u akuzua padrejtësisht në vitin 1960 dhe u pushkatua, ndërsa familja e tij u përball me persekutim të gjatë dhe të dhimbshëm. “Ngjarja e Teme Sejkos u përdor nga regjimi për të goditur strukturat e ushtrisë dhe për të ushqyer klimën e frikës brenda Partisë,” theksoi ai.

Në takim mori pjesë edhe deputeti dhe historiani Ardit Bido, i cili nënvizoi rëndësinë e njohjes së fatit të familjeve të tilla: “Fisi i Sejkove është ndër më të njohurit e Çamërisë. Kontributi i tyre për arsimin dhe pavarësinë është i jashtëzakonshëm. Teme Sejko ishte patriot, por regjimi e shndërroi në armik për të mbjellë frikë. Këto aktivitete na ndihmojnë të themi me bindje se çamët e vërtetë ishin ata që mbrojtën atdheun.”

Anëtari i Autoritetit, z. Altin Hoxha, falënderoi bashkinë, shkollën dhe familjarët e të përndjekurve për mbështetjen dhe pjesëmarrjen, duke theksuar se “Klubi i Librit është pjesë e një programi që zhvillohet në të gjitha shkollat e Shqipërisë për të forcuar kujtesën historike.” Ai shtoi se, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Arsimit, AIDSSH po punon që kujtesa të bëhet pjesë e kurrikulave shkollore.

Në vijim, z. Hoxha ndau një dëshmi rrëqethëse nga dosjet arkivore: njëzet vjet pas vdekjes së Teme Sejkos, Sigurimi i Shtetit hapi një hetim





disamujor për të “vërtetuar” vdekjen e tij. Hetimet, të urdhëruara nga diktatori, përfshinin dëshmi nga pjesëmarrësit në tortura dhe hollësi tronditëse të ekzekutimit. “Tragjedia e familjes Sejko është një pasqyrë e krimeve të komunizmit: një nënë që humbi burrin dhe djalin, dhe që në fund zgjodhi vetëvrasjen, pa e përballuar dot më dhimbjen”, tha ai.

Z. Skënder Vrioni, anëtar i AIDSSH-së, solli dëshmi të tjera nga historia e Sokol Sejkos, djalit të Teme Sejkos, i cili u arrestua në vitin 1973 me akuza të sajura për sabotim të kombinatit të tekstileve në Berat. “Hetuesit nuk arritën ta përulnin Sokolin, megjithëse e torturuan rëndë. Ai qëndroi burrërisht deri në fund dhe refuzoi të nënshkruante kërkesën për falje të jetës. Fjalët e tij të fundit para togës së pushkatimit ishin: Ashtu siç nuk më latë të takoj babanë tim, ashtu edhe sot nuk e latë familjen time të takohet me mua. Afrohuni edhe pak, edhe qëlloni!”



Vrioni shtoi se tragjedia e familjes Sejko përfshin tre breza të flijuar: Teme Sejkon dhe dy vëllezërit e tij, Sokolin dhe nënën e tyre, e cila, e dëshpëruar nga humbjet, u hodh nga kati i katërt i pallatit në Berat. Djali i vetëm i mbetur gjallë, Rajmond Sejko, u burgos për nëntë vjet në Spaç dhe, siç tha më vonë në një intervistë, “nuk arrij ta kuptoj as sot se çfarë i bëmë këtij shteti që na bëri këtë hata.”

Në vijim, z. Alban Velo, mësues i historisë në shkollën “Bido Sejko”, bëri një përmbledhje të librit për të pranishmit, duke u fokusuar në origjinën e familjes Sejko, kontributin e tyre gjatë Luftës së Dytë Botërore, veprimtarinë e Teme Sejkos gjatë viteve 1943–1960 dhe gjyqin politik të grupit çam. Ai theksoi se njohja e historisë lokale është mënyra më e mirë për të lidhur brezat me njëri-tjetrin dhe për të kuptuar më thellë të kaluarën.



Historiani Halil Shabani e përmbylli diskutimin duke kujtuar se Konispoli është ndër zonat më të goditura nga regjimi komunist, ku pothuajse çdo familje ka një histori dhimbjeje. Ai foli për “komplotin çam” si një inskenim politik për të eliminuar figurat më të spikatura të Çamërisë dhe nënvizoi rëndësinë e përkujtimit përmes monumenteve e muzeve, si forma të respektit ndaj të vërtetës dhe kujtesës kolektive.

Në fund të aktivitetit, znj. Elona Baçi nga AIDSSH theksoi se “libri “Ringjallja e Sejkovëve” është më shumë se një dëshmi letrare – është një ndërthurje e kujtesës njerëzore me dokumentin arkivor. Përmes rrëfimit të Ylli Polovinës dhe dokumenteve të ruajtura në arkiv, historia e familjes Sejko del nga errësira e harresës për t’u shndërruar në një dëshmi të gjallë të asaj që ndodhi gjatë regjimit komunist.”



Aktiviteti u mbyll me një reflektim të përbashkët: Kujtesa është përgjegjësi qytetare dhe akt transparence që i shërben së vërtetës dhe pajtimit. Historia e familjes Sejko është histori e Shqipërisë sonë – një kujtesë që na mëson, paralajmëron dhe na detyron të mos harrojmë.

DIALOGU I AIDSSH-SË ME PUSHTETIN VENDOR PËR EDUKIM HISTORIK

Gjirokastrë, 22 tetor 2025

Në mjediset e Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Fato Berberi”, në bashkëpunim me Bashkinë e Gjirokastrës, u zhvillua takimi i radhës i Dialogut të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me pushtetin vendor, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bashkive të qarkut Gjirokastrë dhe disa bashkive të qarkut të Vlorës.

Takimi u zhvillua në kuadër të nismës së Autoritetit për të thelluar bashkëpunimin me pushtetin vendor në tri fusha me rëndësi të veçantë për kujtesën institucionale dhe kulturore të vendit: verifikimin e kandidatëve për tituj vendorë të nderit dhe për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave publike; identifikimin dhe trajtimin e vendvarrimeve të viktimave të komunizmit; promovimin e kujtesës historike përmes muzeve, bibliotekave dhe institucioneve arsimore.



Znj. Kristina Gushi, nënkryetare e Bashkisë së Gjirokastrës, mirëpriti të pranishmit duke vlerësuar takimin si një mundësi të rëndësishme për informim, bashkëpunim dhe ndërgjegjësim të ndërsjellë mes Autoritetit dhe pushtetit vendor. Ajo nënvizoi se bashkitë mbartin një rol të rëndësishëm në ruajtjen e kujtesës historike dhe morale të komunitetit lokal, dhe shprehu gatishmërinë për të forcuar bashkëpunimin me Autoritetin në projektet që lidhen me kujtesën, identitetin dhe historinë e qyteteve.

Në vijim, z. Skënder Vrioni, anëtar i Autoritetit, paraqiti një tablo të plotë të veprimtarisë së Autoritetit, fushën e veprimit dhe përgjegjësitë ligjore që burojnë nga ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, duke theksuar veçanërisht pikat e kontaktit dhe bashkëpunimit me institucionet vendore.

Z. Altin Hoxha, anëtar i Autoritetit, zgjodhi formën e bashkëbisedimit të hapur për të sqaruar përfaqësuesit e pushtetit vendor mbi modalitetet e verifikimit të kandidatëve për tituj nderi dhe emërtimin e hapësirave publike. Ai theksoi se roli i Autoritetit është informues dhe verifikues me mbi bazën e dokumenteve arkivore, ndërsa vendimmarrja përfundimtare i takon pushtetit vendor. Përmes shembujve konkretë, ai ndau problematikat të hasura në kërkesat e deritanishme dhe dha rekomandime për mënyrën e formulimit të tyre, në mënyrë që procesi të jetë sa më i saktë dhe i besueshëm.

“Ky proces do të shërbejë që të kemi një shoqëri të shëndetshme, të kemi bërë ndarjen nga e kaluara komuniste njëherë e mirë. Është në respektin e të gjithë qytetarëve të ecin në rrugët dhe hapësirat publike, emërtimet e të cilëve të mos lëndojnë ndjenjat e tyre apo kujtimin e vuajtjeve të tyre në të kaluarën.”

Një pjesë e rëndësishme e takimit iu kushtua procesit të identifikimit të vendvarrimeve të trupave të pagjetur. Z. Luan Ismaili, koordinator i projektit me Komisionin Ndërkombëtar të Personave të Humbur, theksoi se ky bashkëpunim synon t’u rikthejë dinjitetin viktimave dhe familjeve të tyre, përmes dokumentimit dhe shënjimit të vendeve të ekzekutimeve. Ai prezantoi ekspeditat në terren të realizuara deri më sot, problematikat e ndryshme dhe shpjegoi rëndësinë e vullnetit dhe bashkëpunimit të ngushtë me pushtetin vendor, si çelësi i suksesit në këtë proces.

Ai bëri të ditur se deri më tani janë gjetur 6 vendvarrime dhe janë identifikuar 12 të tjera, duke vënë në dukje se procesi është i ndërlikuar dhe kërkon informacion të saktë historik e lokal. U sollën shembuj bashkëpunimesh të frytshme me bashkitë e Shkodrës, Himarës, Ersekës dhe Tepelenës, si dhe u evidentuan sfidat që lidhen me dokumentacionin e pa-plotë apo me mungesën e dëshmive.

Nga Drejtoria e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar, znj. Brunilda Çërraga prezantoi mënyrën se si dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit mund të shndërrohen në mjete edukimi qytetar dhe historik, përmes aktiviteteve që ndërthurin dokumentin, historinë dhe përvojën jetësore të brezave. Ajo ndau shembuj të ekspozitave dokumentare, klubeve të librit dhe simpoziumeve lokale, që synojnë të sjellin në vëmendje figurat e përjashtuara nga historia zyrtare dhe të fuqizojnë mësimdhënien e historisë së persekutimit komunist në shkollë.

Në përfundim, nënkryetaria e Bashkisë Gjirokastrë znj. Kristina Gushi vlerësoi veprimtarinë si një model të frytshëm bashkëpunimi institucional dhe shprehu interesin e Bashkisë së Gjirokastrës për projekte të përbashkëta me Autoritetin në fushën e kujtesës historike, edukimit qytetar dhe promovimit të vlerave demokratike.

